

Raporti Financiar dhe Makro Për Q2 2019

WVP

FUND MANAGEMENT TIRANA SH.A.

Raporti 6 Mujor i viti 2019 për Investitorët dhe Publikun

ARTON LENA
CEO/CIO

KRISIAN ZAVALANI
EQUITY SALES & TRADING

FONDE INVESTIMI
WVP TOP INVEST

WVP GROUP
Rreth Kompanisë
Rregullimi ligjor

NJOFTIME
WVP Fund Management Tirana

KONTAKT
Rr. Barikadave Nr.118/4/1,
Tiranë, Shqipëri
+355 (4) 22 24 525
contact@wvpfunds.al

Tabela e Zhvillimeve

Hyrje	1
Perspektiva e Tregut.....	2
Analiza e Risqeve	3
Performanca, Statistika dhe Fakte	4
Përfundime, Disa Këshilla nga Ne për Ju.	5

HYRJJE

Të gjithë investitorëve,

Në mbyllje të 3 mujorit të dytë të vitit 2019 ne, **WVP FUND MANAGEMENT TIRANA**, po ju shkruajmë për t'ju rapoortuar mbi performancën dhe ecueshmërinë e fondit **WVP Top Invest**. Në tre muajt e kaluar tregjet kanë pësuar luhatshmëri më të lartë se zakonisht. Bazuar në raportin paraprak fondi priste që të arrinte një çmim për kuotë prej 1040 Lekësh. Fatkeqësisht ky objektivi u përmbush vetëm përkohësisht pasi luhatjet e mëdha të tregjeve botërore nuk na lejuan të avancojmë më tej. Ky raport ju kushtohet kryesisht investitorëve tanë por jep informacion edhe për individët ose institucionet publike e private të interesuara në veprimtarinë tonë.

Ngjarjet më e rëndësishme e këtij 3 mujori në tregjet financiare ishin rënia e madhe e tregjeve për shkak të tensioneve USA-Kinë dhe lëvizjet e pritshme nga Bankat Qëndrore Europiane dhe Amerikane. Te dyja këto ngjarje janë e një rendësie shumë të madhe për fondin dhe performancën dhe politikën e tij.

“Gjithashtu ekonomia Shqipëtare vazhdon të humbë besimin nga konsumatorët dhe pritet që kriza politike në vënd mund të ndikojë tek ajo” (Banka e Shqipërisë).

Një arsye më shumë për ju investitorët që të diversifikoni riskun e investimeve tuaja duke investuar ne WVP Top Invest dhe ne atë mënyrë duke marrë pjesë në rritjen e ekonomisë botërore.

Raporti i mëposhtëm do të jetë i përmbledhur dhe solid në pikat më kryesore të vëmëndjes tonë rreth strategjive të fondit **WVP Top Invest** dhe ekonomisë botërore, faktorë këta që ndikojnë drejtpërdrejt në performancën tonë.

Perspektiva e Tregut

Në këto momente që shkruajmë ambienti investues në të cilin ndodhemi është në një gjëndje të trazuar, por çmimet e aksioneve në bursat e zhvilluara vijnë rritjen. Performanca e tregjeve botërore financiare ka qënë shumë e lëkundur dhe pasiguria ka mbizotëruar në tregje. Në letrën tonë vjetore shkruam se prisnim katër risqe kryesore për të menaxhuar:

1. Yield Curve
2. Borxhi i Akumuluar i Korporatave
3. Normat e pritura të interesit bazë në Amerike dhe Europë
4. Ngadalësimi i ekonomisë botërore

Synimi i fondit vazhdon të mbetet i njëjtë me qëllim arritjen e:

1. Cilësisë të kompanive ku blihen aksionet
2. Vlerës dhe diversifikacionin që u ofron investitorëve në Shqipëri
3. Likuiditetit
4. Fitimeve solide në horizont afatgjatë.

Risqet e pritura vazhdojnë të mbeten të njëjta si më parë por pesha e ndikimit të tyre duket se ka ndryshuar. Rrolin kryesor e kanë marrë tensionet tregëtare midis USA dhe Kinës. Yield Curve nuk duket të jetë më një shqetësim primar për momentin pavarësisht se Yield-i i Obligacioneve Qeveritare Gjermane 10 vjeçare ra për herë të parë në histori në një nivel më të ulët se sa norma bazë e interesit të Bankës Qëndrore Europiane. Kjo ishte një shënjë që investitorët presin dhe po vënë nën presion Bankat Qëndrore që të lehtësojnë politikën monetare me qëllim stimulimin e ekonomisë.

Të gjithë këta faktorë do të analizohen në seksionin e më poshtëm duke ju dhënë një ide më të qartë se çfarë të prisni në vijim dhe si të interpretoni të dhenat e tregjeve dhe ekonomisë botërore.

Analiza e Risqeve

1. Yield Curve

Yield Curve perfaqëson kurben e obligacioneve të një kulaiteti kredie (Credit Quality) të njëjtë por maturimi të ndryshëm. Historia ka treguar se është një nga parashikuesit më të mirë të ecurisë së ekonomisë botërore. Në një rrjedhë normale kurba është rritëse që do të thotë se obligacionet afatshkurtëra kanë një interes më të ulët se obligacionet afatgjata. Kjo gjë është logjike sepse një borxh afatgjatë mbart në vetvete risk më të lartë si psh. risku i inflacionit, risku i kthimit të principalit, risku i interesit, risku i kohës dhe risku i likuiditetit.

Në këtë moment që shkruajmë Yield Curve është e drejtë, që do të thotë se norma e interesit për obligacionet afatgjata dhe afatshkurtëra janë pothuajse të njëjta. Arsyeja kryesore e kësaj ndodhie vjen për shkak se tregjet Amerikane raportuan rritje të punësimit më të lartë se sa pritej. Kjo gjë tregon që ekonomia kryesore botërore është ende e fortë dhe ul probabilitetin e uljes së normave bazë të interesit nga bankierët qëndrorë.

Date	1 Mo	2 Mo	3 Mo	6 Mo	1 Yr	2 Yr	3 Yr	5 Yr	7 Yr	10 Yr	20 Yr	30 Yr
07/01/19	2.17	2.16	2.21	2.10	1.94	1.78	1.74	1.79	1.90	2.03	2.34	2.55
07/02/19	2.21	2.17	2.20	2.09	1.91	1.77	1.71	1.75	1.85	1.98	2.29	2.51
07/03/19	2.25	2.20	2.21	2.08	1.91	1.77	1.71	1.74	1.83	1.96	2.25	2.47
07/05/19	2.26	2.22	2.23	2.14	1.98	1.87	1.82	1.84	1.93	2.04	2.34	2.54
07/08/19	2.23	2.24	2.26	2.14	1.99	1.88	1.84	1.86	1.94	2.05	2.32	2.53

Figura 1 U.S Department of Treasury

2. Borxhi i Akumuluar i Korporatave

Në këtë pikë nuk kemi asnjë zhvillim të ri dhe gjëndja vazhdon të jetë e njëjtë. I vetmi risk shtesë që shohim është shtimi i borxhit të korporatave pasi siç shpjeguam në fillim të këtij raporti normat e obligacioneve 10 vjeçare janë shumë të ulta. Për një përshkrim më në detaje të riskut të borxhit të korporatave ju lutem ti drejtoheni raportit tonë të mëparshëm për Q1 2019.

3. Normat e pritura të interesit bazë në Amerike dhe Europë

Federal Reserve (Banka Qëndrore Amerikane) ka qënë në qëndër të vëmëndjes në të gjithë këta muaj pasi investitorët dhe tregjet kanë vënë në presion autoritetin qëndror financiar ne Amerikë për të ulur normat bazë të interesit në mënyrë që të stimulohet rritja ekonomike. Fatmirësisht FED ka treguar një qëndrueshmëri të mirë dhe duket se po i mer parasysht gjithë pritshmëritë e tregut dhe në muajin Korrik do të jemi në pritje të vendimit të tyre. Megjithatë pak mundësi ka që norma bazë të ulet me 50 pikë ose më shumë pasi të dhënat e fundit të puësimit ishin më të mira se sa pritej.

4. Tensionet USA-Kinë dhe ngadalësimi i ekonomisë botërore

Risku më serioz dhe ai që ishte shkakëtari i uljes së tregjeve ishin tensionet midis Amerikës dhe Kinës. Fatkeqësisht gjatë muajve kemi dëgjuar her lajm të mira për një marrëveshje her të kundërtën vetëm pak ditë më vonë. Pasiguria në këtë pikë është e lartë dhe karakteri i Donald Trump nuk na jep siguri në asnjë fjalë të tij për shkak se shumë herë më parë ka thënë se do të arrihet një marrëveshje vetëm për ta prishur gjithëshka pak ditë më vonë. Në këto kushte ne e cilësojmë për momentin këtë risk si sistematik dhe të pa diversifikueshëm pasi faktet tregojnë se ka fuqinë të lëvizë të gjithë tregjet botërore.

Përsa i përket ekonomisë botërore vihet re inflacioni i ulët në të gjitha ekonomitë kryesore dhe sipas sondazheve të ndryshme ka deri në 33% mundësi të kemi një recesion ne 2 vitet e ardhëshme. Ende nuk kemi pasur ndonjë zhvillim kyç të ri krahasuar me raportin e mëparshëm.

Performanca, Statistika dhe Fakte

Në këtë 6 muaj të parë **WVP Top Invest** ka pasur rritje me një **fitim NETO** për investitorët në vlerën e **13,94 %**. Falë diversifikimit dhe menaxhimit të risqeve fondi vazhdon të qëndrojë në të njëjtat nivele raportuar më date **30.06.2018**. Fondi arriti të jete afër Benchmark-un e tij i cili në të njëjtë kohë u rrit me 15,05%.

Benchmark-u llogaritet si një miks i tregjeve Europiane dhe Amerikane për shkak se këto janë kontinentet ku fondi ka prezencë në investime.

Në rast se kthimi i fondit është më i lartë se i Benchmark kjo do të thotë që ne i kemi kaluar në performancë tregjet në tërësi në të cilat ne investojmë.

Pra nëse ju do të investonit njëkohësisht ne fond plus të blinit çdo kompani të mundëshme të cilat ekzistojnë brënda universit në të cilin fondi selekton do të kishit një fitim më të ulët.

Kjo tregon që fondi ka përzgjedhur kompani të cilat kanë performuar më mirë se mesatarja e tregut në tërësi.

Performance

	WVP Top Invest %	WVP Benchmark ** %
1M	4,73	4.64%
3M	-0,02	1.78%
6M	13,94	15.05%
1 Year	2,36	6.81%
YTD	13,94	15.05%

Total Return since
inception % 2,30


Vlera NETO e asetëve dhe kuota e fondit për datën **30.06.2019** qëndrojnë në vlerën e **97.725.548,88 Lekë** dhe **1.022,9974 Lekë/Kuotë**. Fondi arriti një devijim standart prej **11.95%** dhe ju atashua nota e riskut **5 (Risk Mesatar)**. Për më në detaje bashkëngjitur të dhënat:

Information about the Fund

Name of the Fund	WVP Top Invest
Inception Date	29/03/2018
Currency of the shares	LEK
Net value	97.725.548,88 ALL
Unit Price	1.022,9974 ALL
Fund Type	Accumulation
Custody Bank	First Investment Bank Albania
Subcustody Bank	First Investment Bank Bulgaria
	Clearstream
Benchmark	WVP Benchmark
Standard deviation	11.95%
Risk class	5


Historiku i çmimit të kuotës deri më **30.06.2019**:

Unit price



Përsa i përket ekspozimit gjeografik investimet tona vazhdojnë të jenë më të përqëndruara në Amerikë, Gjermani dhe Francë, me pjesën tjetër të alokuar në shtete të tjera të zhvilluara Europiane. Më poshtë gjeni të dhënat e detajuara mbi Ekspozimin Gjeografik të WVP Top Invest:


Geographic Exposure



WVP Top Invest vazhdon të përqëndrojë pjesën më të madhe të investimeve në në Shërbimet Financiare, Kompanitë Framaceutike & Biotech dhe Industrinë e lëndëve të konsumit të përditshëm, kjo e fundit për shkak të qëndrueshmërisë më të lartë që këto kompani kanë në bursa. Kompanitë Framaceutike & Biotech kanë luhatshmëri më të lartë por dhe fitime të pritura më të mëdha dhe ne i kemi kombinuar me industrinë mbrojtëse për të pasur një kosto/benefit të pëlqyeshëm dhe në mënyrë që të menaxhohen risqet por në të njëjtën kohë duke sjellë fitime më të larta se mesatarja në afatgjatë.


Më poshtë gjeni të detajuar ekspozimin e WVP Top Invest në industrinë përkatëse:

Sectoral Exposure




Përsa i përket riskut monetar më datë **30.06.2019** një përqindje e papërfillshme ndodhej në llogaritë tona në Lekë dhe gjithë asetet ishin në valutë. Këto vlera llogariten pas aseteve Cash të lëna mënjanë për detyrimet afatshkurtëra të fondit. Kjo do të thotë se fondi ka nevojë për kapital shtesë për të vazhduar të investojë në kompani të tjera apo për të rritur zotërimin në kompani ekzistuese.

Exposure by Type of Instrument



Currency Exposure



Gjatë këtij 3 mujori në portofolin tonë janë shtuar dy kompani të reja në të cilat fondi ka investuar. Ato janë:

1. **Goldman Sachs Group Inc. (NYSE: GS)**
2. **British Petroleum PLC. (LSE: BP)**

Kompanitë tregëtohen në bursën e New-York-ut dhe Londrës me simbolet e lartpërmendura. **Goldman Sachs** është Banka e Investimeve më prestigjioze në planet dhe së fundmi ka deklaruar se do të rrisë dividendin për investitorët. Gjithashtu gjigandi financiar ka hyrë dhe në sektorin e kredithënies pra aktiviteteteve të Bankave Komerçiale së fundmi dhe e ardhmja duket premutese.

British Petroleum është një nga kompanitë më të mëdha në botë të naftës dhe gazit natyror dhe pjesë e 7 Superkompanive në këtë fushë. Fondi ishte nën peshë përse i përket industrisë së **Energjisë** dhe ekspozimit në **GBP** dhe **BP** ishte një zgjidhje ideale për të rikthyer balancat në portofol.



Portofoli i Kompanive të Top Invest

No.	Name Of The Company	ISIN	Currency	No. Of Shares	Price	Exchange Rate	Value in ALL	% NAV
1	Procter & Gamble Co/The	US7427181091	USD	330	109.4600	107.690000	3,889,956.64	3.98%
2	Diageo PLC	GB0002374006	GBP	800	33.8350	136.520000	3,695,323.36	3.78%
3	Nestle	CH0038863350	CHF	328	101.0400	110.450000	3,660,436.70	3.75%
4	Walmart Inc	US9311421039	USD	295	110.4300	107.690000	3,508,200.98	3.59%
5	Pfizer Inc	US7170811035	USD	735	43.3300	107.690000	3,429,662.66	3.51%
6	Facebook Inc	US30303M1027	USD	160	192.9800	107.690000	3,325,122.59	3.40%
7	Apple Inc	US0378331005	USD	150	197.9100	107.690000	3,196,939.19	3.27%
8	British Petroleum PLC	GB0007980591	GBP	4,250	5.4860	136.520000	3,183,032.06	3.26%
9	HeidelbergCement AG	DE0006047004	EUR	360	71.0600	122.650000	3,137,583.24	3.21%
10	Roche Holding AG	CH0012032048	CHF	100	274.5500	110.450000	3,032,404.75	3.10%
11	Zurich Insurance Group AG	CH0011075394	CHF	80	339.9000	110.450000	3,003,356.40	3.07%
12	Allianz SE	DE0008404005	EUR	115	211.5500	122.650000	2,983,859.86	3.05%
13	Unilever NV	NL0000009355	EUR	455	53.4100	122.650000	2,980,585.11	3.05%
14	SANOFI SA	FR0000120578	EUR	320	75.9100	122.650000	2,979,315.68	3.05%
15	BOEING	US0970231058	USD	75	364.0600	107.690000	2,940,421.61	3.01%
16	EXXON MOBIL CORP	US30231G1022	USD	350	76.6100	107.690000	2,887,545.82	2.95%
17	Royal Dutch Shell PLC	GB00B03MLX29	EUR	820	28.7100	122.650000	2,887,450.83	2.95%
18	Merck KGaA	DE0006599905	EUR	250	91.9800	122.650000	2,820,336.75	2.89%
19	UNITED TECHNOLOGIES CORP	US9130171096	USD	200	130.1100	107.690000	2,802,309.18	2.87%
20	TOTAL SA	FR0000120271	EUR	455	49.2750	122.650000	2,749,828.33	2.81%
21	AXA SA	FR0000120628	EUR	965	23.0600	122.650000	2,729,318.19	2.79%
22	Siemens AG	DE0007236101	EUR	200	104.8600	122.650000	2,572,215.80	2.63%
23	Volkswagen Ag	DE0007664039	EUR	135	148.2200	122.650000	2,454,189.71	2.51%
24	Deutsche Post AG	DE0005552004	EUR	690	28.8650	122.650000	2,442,801.65	2.50%
25	Lloyds Banking Group PLC	GB0008706128	GBP	27,850	0.6224	136.520000	2,366,415.84	2.42%
26	Goldman Sachs Group Inc	US38141G1040	USD	102	204.4700	107.690000	2,245,976.18	2.30%
27	Intercontinental Exchange Inc	US45866F1049	USD	235	85.7100	107.690000	2,169,075.83	2.22%
28	BASF SE	DE000BASF111	EUR	260	64.0200	122.650000	2,041,533.78	2.09%
29	Berkshire Hathaway Inc	US0846707026	USD	88	212.4400	107.690000	2,013,234.40	2.06%
30	Henkel AG & Co KGaA	DE0006048432	EUR	190	86.2800	122.650000	2,010,625.98	2.06%
31	Fresenius SE & Co KGaA	DE0005785604	EUR	340	47.5700	122.650000	1,983,716.57	2.03%
32	Telefonica SA	ES0178430E18	EUR	2,200	7.2800	122.650000	1,964,362.40	2.01%
33	ING Groep NV	NL0011821202	EUR	1,530	10.1920	122.650000	1,912,574.66	1.96%
34	Bayerische Motoren Werke AG	DE0005190003	EUR	235	64.9900	122.650000	1,873,190.52	1.92%
35	Daimler AG	DE0007100000	EUR	300	49.0550	122.650000	1,804,978.73	1.85%
36	BNP Paribas SA	FR0000131104	EUR	345	41.7650	122.650000	1,767,254.65	1.81%

Fondi zotëron 36 kompani dhe nuk ka në planet e tij afatshkurtëra të shesë asnjë nga pozicionet e tij në kushte tregu normale.

Përfundime, Disa këshilla nga Ne për Ju...

Ashtu si në raportet tona të mëparshme po e përmbyllim këtë raport duke ju siguruar edhe njëherë se:

Në të gjithë historinë e tregjeve financiare **3 gjëra janë gjithmonë të sigurta;**

1. Tregjet do të kenë **GJITHMONË** luhatshmëri
2. Në afatgjatë tregjet **GJITHMONË** rriten sepse ekonomia botërore është vazhdimisht në rritje
3. Gjatë periudhave të vështira frika është **GJITHMONË** ngjitetëse;

Siç tashmë dhe faktet tregojnë luhatshmëria është e dukshme. Nga një performancë ulët në fund të 2018 investitorët panë fitime prej **11.94%** në vetëm 3 muajt e parë të 2019 e më pas fondi vijoi pa rritje duke u mbyllur në të njëjtin nivel ku ishte në **Mars 2019**. Sigurisht në afatgjatë fondi pret vetëm rritje por duke pasur luhatshmëri her pas here të cilat janë normale siç mund të vërehet.

Investitorët KUJDES!

Ky seksion përfundimatar ju dedikohet specifikisht ju. Gjatë periudhës **Tetor 2018-Qershor 2019** siç e shikoni shumë ndryshime kanë ndodhur. Ne duam t'ju kushtojmë pak nga koha jonë për t'ju dhënë këshillën më të vlefshme:

“ Gjithmonë investoni periodikisht dhe rregullisht. Nuk ka rëndësi nëse keni investime të mëdha apo të vogla. Ju duhet të investoni optimalisht çdo muaj për të përfituar blerjen e kuotave me çmim mesatar. Ne nuk këshillojmë të investoni të gjitha paratë tuaja menjëherë. Investitorët të cilët nuk investuan nga Dhjetori 2018-Mars 2019 humbën rreth 20% rritje të kapitalit të tyre. Gjithashtu ata që pësuan rënie të investimit në fund të 2018 jo vetëm i rikuperuan humbjet por arritën të blejnë kuota me çmime SHUMË të lira krahasuar me sot. Për më tepër gjatë periudhës Mars-Qershor luhatjet ishin të mëdha dhe një investim i rregullt u siguroi investitorëve të përfitonin kuotat me çmime të ndryshme duke siguruar një kosto mesatare në periudhë kohore afatgjatë. Mos u përpiaqi të parashikoni uljet dhe ngritjet e tregut sepse është e pamundur. Askush nuk mund të gjejë kohën perfekte për të investuar. Na besoni në këtë rrugëtim dhe na lejoni t'ju shërbejmë sa më mire”

Ju Faleminderit!